

“Anketimi Kombëtar 2014 mbi Perceptimet dhe Pritshmëritë drejt Anëtarësimit të Mundshëm të Shqipërisë në BE”

27 mars 2015, EU Info Center

*Fjala e Drejtorit Ekzekutiv të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
(Soros)*

Z. Andi Dobrush

E nderuar znj. Ambasadore Vlahutin,
E nderuar znj. Ministre Gjosh,

Të dashur miq,

Është gjithmonë një kënaqësi për mua të flas për integrimin europian duke u fokusuar tek kombinimi i njohurive dhe nxitja e debatit të gjeneruar nga analizat akademike, rrugë e cila besoj se mund të prodhojë shumë ide për përmirësim dhe ndryshim për të gjithë ne.

Prej shumë vitesh Fondacioni ka testuar idenë e financimit dhe organizimit të sondazheve periodike kombëtare duke përdorur teknika të ndryshme. Nëpërmjet prodhimit të këtyre anketimeve dhe hulumtimeve në bashkëpunim me grupet e interesit, do të bëhej e mundur përmirësimi i monitorimit, advokimit hartimit të polikave bazuar në të dhëna të sakta.

Prej mesit të viteve 2000, Fondacioni ka filluar traditën e mbështetjes së procesit të integritit duke informuar qytetarët mbi këtë proces dhe ndikimin që mund të ketë mbi jetën e tyre. Kjo pasi ne besojmë se monitorimi i zbatimit të angazhimeve të Qeverisë Shqiptare dhe angazhimi i grupeve të shoqërisë civile dhe qytetarëve të informuar në këtë debat do të na mundësonte të ecnim me hapa më të shpejtë.

Falë mbështetjes së Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri, Fondacionin ndërmori në 2014 “Anketimin kombëtar mbi Perceptimet dhe Pritshmëritë drejt Anëtarësimit të Shqipërisë në BE”. Studimi ofron informacion të detajuar mbi nivelin e dijes dhe të kuptuarit të qytetarëve shqiptarë mbi BE-në, punës së saj dhe çfarë nënkupton procesi i integritit. Studimi hedh dritë mbi kanalet e informacionit më të përdorura nga qytetarët kur kërkojnë informacione mbi BE-në dhe integrimin european dhe shpjegon faktorët që ndikojnë.

Rezultatet e anketimit të Shqipërisë janë shumë interesante pasi falë përdorimit të metodologjisë së Sondazhit Social European dhe variablave të 5 Eurobarometrave mundësohet paraqitja e krahasuara me rezultatet e vendeve të tjera europiane. Falë eksperiencës së mëparshme me Sondazhin Social European, Fondacioni vazhdon traditën për të përdorur një nga metodologjitë më solide të realizimit të hulumtimeve, duke e vendosur Shqipërinë në hartën më të plotë dhe të besueshme të studimeve sociale në Europë.

Dua të fokusohem në vazhdim në disa prej gjetjeve kryesore të anketimit, dhe më pas Klodi do të vazhdojë me një prezantim më të detajuar të tyre.

Së pari pavarësisht gjithë dallimeve që mund të kemi si shoqëri, ka të paktën një gjë madhore që na bashkon, besimi se antarësimi në Europë mbetet destinacioni i dëshirave të shumicës dërrmuese të shqiptarëve me 87%, shumë më tepër se Maqedonia me 50%, Mali i Zi me 44%, Turqia 38% dhe Serbia me 36%. Po ashtu 92% e shqiptarëve mendojnë se vendi ynë do të përfitojë nga të qenit një vend anëtar. Përsëri një besim shumë më i lartë se Maqedonia me 60%, Mali i Zi me 54%, Turqia 43% dhe Serbia me 42%. Kjo duhet të shtyjë dhe nxisë forcat politike të cilitdo orientim, të punojnë për këtë qëllim, me plane e afate të përcaktuara qartë, me sisteme monitorimi funksionale dhe, mbi të gjitha, transparente për publikun. Këto të fundit kanë munguar dhe janë deri diku arsytet e vonësive në plotësimin e kushteve dhe detyrave.

Së dyti 57% e shqiptarëve përgjigjen se janë të informuar shumë ose mjaftueshëm mbi procesin e integritit duke u renditur të dytët mbas

Turqisë me 58%, ndërkohë që ata renditen të pestët nga fundi për sa i përket njohurive të detajuara mbi institucionet europiane. Në këtë drejtim konstatohet se ka nevojë shumë të madhe për ta shpjeguar Europën, që mund të ndihmojë edhe vetë qytetarët të vetëndërgjegjësohen drejt “europianizimit” të tyre.

Së treti shqiptarët tentojnë të besojnë shumë më shumë te institucionet ndërkombëtare ku kryeson BE-ja me 96%, ndjekur nga Kombet e Bashkuara me 94%, ndërkohë që vetëm 49% besojnë tek Qeveria shqiptare, 39% tek Parlamenti dhe 15% tek partitë politike. Politikanët dhe institucionet shqiptare duhet të përmirësojnë angazhimin dhe punën e tyre me publikun, jo vetëm duke simpatizuar procesin e integritetit por edhe duke nxitur ndryshimet që mund të përjetohen nga qytetarët në jetën e përditshme.

Së katërti 53% e shqiptarëve mendojnë se vendi është gati t’i bashkohet BE-së, dhe 43% mendojnë se nuk është. Po ashtu 69% e shqiptarëve mendojnë se BE duhet të na pranojë si një anëtar edhe pse Shqipëria nuk është gati. Megjithatë nëse të nesërmen do të zhvillohej një referendum mbi anëtarësimin e Shqipërisë në BE, 91% e shqiptarëve do të votojnë për të.

Së pesti kontributi i BE në përmirësimin e jetës së Shqipërisë duke filluar nga liberalizimi i vizave deri në përmirësimin e jetës së qytetarëve, duke kompensuar në disa aspekte edhe të metat e qeverive kombëtare. Megjithatë në 2 deri 5 vitet e ardhshme 63% e shqiptarëve do ta konsideronin punësimin në një nga shtetet anëtare të BE. Nga këta 81% do të ikni për një pagë më të mirë, 41% kërkojnë mundësi zhvillimi profesional dhe 35% e tyre nuk mund të gjejnë një punë në Shqipëri.

Nuk dua t’ju mbaj duke u ndalur te përfundimet dhe rekomandimet në fjalë, por do të veçoj vetëm një:

- Përmirësimi i marrëdhënies mes shoqërisë civile dhe institucioneve publike në procesin e integritetit.

Shoqëria civile shqiptare tashmë mbart mjaft ekspertizë në shumë fusha dhe është mëse e gatshme t'i bëjë njohuritë e saj të dobishme në këtë drejtim. Për këtë, na duhen institucione të cilat jo vetëm na ftojnë në tavolinat e konsultimit por edhe që janë të hapura të angazhohen në një dialog të vazhdueshëm dhe sidomos teknik mbi procesin e integritit, dhe të pranojnë kontributin tonë.

Shpresoj që këto rezultate të jenë të dobishme jo vetëm për informimin e qytetarëve, por edhe më konkretisht për institucionet dhe të gjithë ne në mënyrë që të përmirësojmë angazhimet tona drejt qëllimit të përbashkët që është integrimi europian.

I falenderoj pjesmarresit, dhe jam i bindur se prezantimi i rezultateve do t'ju sjelli ushqimin e duhur për një debat sa më konkret mbi integrimin europian në vijim.